



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 183 Nr. i faq/Br.str/No.pg 61

Data/Datum/Date 30/01/2024

Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 e shkronjës d), nenit 17 e shkronjës f) dhe nenit 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), dispozitave të Ligjit nr.04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr. 11/2014 për themelimin, zgjedhjen, përgjegjësitë dhe funksionimin e Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe, nenit 2 dhe 10, të paragrafit 2, të pikës 2.4, nenit 40 dhe nenit 57, të paragrafit 1, pikës 1.5 të Statutit të Komunës së Rahovecit nr.1005, i dt. 29.03.2017 dhe shkresës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me nr.prot.67-2/24, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.01.2024 miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit të punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, janar-dhjetor 2024

1. Me këtë vendim miratohet Plani i punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, janar-dhjetor 2024.
2. Shtojcë e këtij vendimi është edhe Plani i punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, janar-dhjetor 2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me nr. prot. 167/23, i datës 27.12.2023.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr. 06/2021, dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Sekretarisë së Kuvendit,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.183/24
Datë:30.01.2024

